

Nr. 4937/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË  
MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 19, datë 30.08.2016

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT,  
PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 31, datë 20.01.2001, "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar:

U D H Ë Z O J:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 31, datë 20.01.2001 të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetëmijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj.
2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 31, datë 20.01.2001 të ndryshuar, bëhet 10.650 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 Shtator i vitit 2016 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
4. Udhëzimi nr. 23, datë 20.08.2015 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 01.09.2016.

Blendi Klosi

MINISTËR

